Numër: 01/132
Datë: 31.03.2023

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 27.03.2023 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet** institucioni Instituti për Kualifikime Profesionale - KTC, me adresën: Arbëria 1 Lagja Ulpiana, Fushë Kosovë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 27.03.2023 deri 26.03.2026, me përjashtim të kualifikimit Instalues Elektrik, që është për periudhën dy (2) vjeçare, përkatësisht nga data 27.03.2023 deri 26.03.2025, me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

   1.1 Bërës Ëmbëlsirash, Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 21 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri me dymbëdhjetë (12) kandidat në një grup, dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në gjashtë (6) grupe, gjithsej 72 kandidatë brenda vitit.

   1.2 Grimer, Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 21 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri me dymbëdhjetë (12) kandidatë në dy grupe në të njëjtën kohë (një grup paradite dhe një grup pasdite), gjithsej 24 kandidatë brenda vitit.

   1.3 Instalues Elektrik, Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 22 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri me dymbëdhjetë (12) kandidat në një grup, dhe

gjatë një viti mund të mbahen deri në gjashtë (6) grupe, gjithsej 72 kandidatë brenda vitit.

1.4 **Instalues i Ngrohjes Qendrore,** Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 24 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri me tetë (8) kandidat në një grup, dy grupe në të njëjtën kohë (një grup paradite dhe një grup pasdite), dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në katër (4) grupe, gjithsej 32 kandidatë brenda vitit.

1.5 **Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit,** Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 24 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri me tetë (8) kandidat në një grup, dy grupe në të njëjtën kohë (një grup paradite dhe një grup pasdite), dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në katër (4) grupe, gjithsej 32 kandidatë brenda vitit.

1.6 **Manykyrist,** Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 18 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri me tetë (8) kandidat në një grup, dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në tre (3) grupe, gjithsej 24 kandidatë brenda vitit.

1.7 **Ndihmës Kuzhinier,** Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 24 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri me dymbëdhjetë (12) kandidat në një grup, dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në tetë (8) grupe, gjithsej 96 kandidatë brenda vitit.

1.8 **Parukeri,** Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 24 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri me dymbëdhjetë (12) kandidat në një grup, dy grupe në të njëjtën kohë (një grup paradite dhe një grup pasdite), gjithsej 24 kandidatë brenda vitit.

1.9 **Pedikyrist,** Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 18 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri me tetë (8) kandidat në një grup, gjithsej 8 kandidatë brenda vitit.

1.10 **PICAMEN (përpunues i picës),** Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 20 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri me dymbëdhjetë (12) kandidat në një grup, dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në katër (4) grupe, gjithsej 48 kandidatë brenda vitit.

2. **Refuzohet** akreditimi i institucioni Instituti për kualifikime profesionale KTC, me adresën: Arbëria 1 Lagja Ulpiana, Fushë Kosovë, Republika e Kosovës, për kualifikimin: **Muratorë dhe Punëtorë të Ngjashëm,** niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 25 kredi të AAP.

3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së Instituti për kualifikime profesionale KTC, për validim, akreditim dhe rekomandimeve të dala nga raportet e vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe raportet e ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportet e hartuar ka dhënë vlerësim pozitiv për pikën I si në dispozitiv (me të gjitha nënpikat), dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ekipi i jashtëm i ekspertëve me datë 12/10/2022, 19/10/2022, 26/10/2022, 23/11/2022, 12/12/2022, ka shqyrtuar dokumentacionin e institucionit KTC, ndërsa me datë 20/10/2022 ka vizituar institucionin KTC lidhur me aplikimin për akreditim dhe validim për kualifikimin Muratorë dhe Punëtor të Ngjashëm.

Me datë 29.12.2023 përmes emailit zyrtar institucionit KTC i është dërguar draft raporti për kualifikimin: Muratorë dhe Punëtor të Ngjashëm, e në të cilin është theksuar se: *"Komentet rreth këtij raporti duhet të kthehen në kohë pesë (5) ditë pune nga koha e dërgimit"*. Institucioni KTC me datë 12.01.2023, përmes emalit zyrtar i kthen komentet lidhur me draft raportin e ekipit të eksperteve.

Ekipi i ekspertëve vlerësues në raportin e validimit dhe akreditimit për institucionin KTC, lidhur me kualifikimin Muratorë dhe Punëtor të Ngjashëm, në pjesën 2: *Rezultatet e përgjithshme dhe përfundimet,* ekspertët kanë vlerësuar se: *"Institucioni ka në shfrytëzim përmes qiramarrjes një objekt me shumë hapësira ku për kualifikimin "Muratorë dhe punëtorë të ngjashëm" ka në dispozicion dy kthina: njëra për mësim teorik S=44m² dhe kthina për mësim praktik S=64m². Qendra nuk posedon hapësirë të mjaftueshme për vijimin e praktikes profesionale në punëtorinë e prezantuar. Duhet të ketë hapësire që të mundësoj praktikimin e të gjitha*

elementeve ndërtimore te parapara në RM të moduleve përkatës për kualifikimin "Muratorë dhe punëtor të ngjashëm"

- Kthina për mësim praktik ka një sipërfaqe prej S=64m², gjysma e kthinës shërben për ruajtjen e mjeteve dhe pajisjeve për punë praktike. Në kthinë ka kushte për të qenë prezent një numër i vogël i kandidatëve.

- Në këtë kthinë mungon ventilimi adekuat për të mirëmbajtur kthinën me ajër të freskët

- Në kuadër të objektit nuk ka kthinë për magazinimin e materialeve rrethanore dhe atyre lidhës (një pjesë e prezantuar jashtë objektit është pronë publike dhe institucioni nuk ka asnjë dokument nga institucione përkatëse për shfrytëzim dhe drejtpërdrejte mund të ndikojë në cilësinë e jetës së banorëve)

- Institucioni nuk ka paraparë kontejner të veçantë për largimin e mbeturinave inerte që prodhohen gjatë procesit të mësimit praktik.

- Mungon platformë e punës për implementim praktik të muratimit të mureve me materiale të ndryshme, forma të ndryshme dhe lidhja e tyre. Në kuadër të kthinës nuk ka kushte për përgatitjen e llaqit për muratim.

- Kthina për mësim praktik nuk ka kushte për implementim të kallupimit dhe armimit të elementeve të ndryshme apo pjesëve të tyre. Prerja, lakimi dhe lidhja e armaturës kërkon hapësirë dhe kushte specifike.

- Mungon platformë për aplikimin e strukturave prej guri

- Kthina nuk ofron kushte për përgatitjen e llaqit dhe implementimin e suvatimit, duhet krijuar kushte që gjatë suvatimit me dorë apo makinë të mbrohet pjesa tjetër e ambientit.

- Kthina nuk ofron kushte për përgatitjen e materialit dhe mungon hapësira për vendosjen e estrihut

- Mungon platforma për implementimin e pllakave të qeramikës (dysheme dhe muri)

- Nuk ka kushte për fiksimin/vendosjen e profilave vertikal nga alumini për të formësuar strukturën e mureve (ndarjeve) nga rigipsi. Gjithashtu nuk ka kushte për fiksimin e elementeve për të formësuar strukturën e tavaneve. Rekomandohet të përgatitet strukturë ndihmëse nga metali apo druri".

Ekipi i ekspertëve vlerësues në raportin e validimit për institucionin KTC, lidhur me kualifikimin Muratorë dhe Punëtor të Ngjashëm, në pjesën 2 "*Rezultatet e përgjithshme dhe përfundimet*", ekspertët vlerësojnë se: " *2. Mungon lista e kuadrit/stafit edukativo-arsimor dhe aftësues për modulet përkatëse 3. Rregullore për shëndet dhe siguri ne punë - duhet te plotësohet në përputhje me ligjet e aplikueshme, siq jane: a) vlerësimi i vendeve te rrezikshme te punës b) trajnimi i stafit nga kompani e licencuar (është prezantuar një certifikate) c) Gjithashtu duhet te prezantohet edhe plani për trajtimin I mbeturinave te ngurta qe prodhohen gjate procesit te trajnimit. Mungojnë kontejnerët për largimin e mbeturinave të ngurta. f) Moduli kryesore i këtij profili, Moduli IV – "Muratimi me blloqe dhe tulla si dhe montimi i strukturave prej guri." Tek pjesa b) e dokumentit Programi nuk përmban rezultatet thelbësore mësimore qe duhet te I përmbaje ky modul qe janë te përshkruara ne Standardin e Profesionit, siq janë: – Muratimi me lloje te*

ndryshme te materialeve mësimore ¬ Muratimi i elementeve me forma te ndryshme ¬ Përforcimi i elementeve te muratures, etj. Kandidati i cili do te ndjeke këtë modul nuk do te aftësohej fare për këto aktivitete te ndërtimit. g) Mungon një tabele ku për secilin modul kryesore paraqiten shkathtësitë profesionale dalëse si dhe kompetencat sipas KKK për secilin modul. h) Nuk ka plan se cilat aktivitetet trajnuese ne cilat do te ofrohen ne qendër te trajnimin dhe aktivitetet te cilat do te ofrohen ne vend-pune dhe si do te zhvillohet mbarëvajtja e aktiviteteve ne vend-pune. Instrumentet e vlerësimit janë shume te mangëta. Janë te paraqitura testet teorike për secilin modul por mundon testi praktik për secilin modul. Testi praktik përfundimtare është shume i mangët dhe nuk mundëson vlerësimin e kandidati konform kërkesave për shkathtësi profesionale te nivelit te III sipas KKK".

Ekipi i ekspertëve vlerësues në raportin e validimit për institucionin KTC, lidhur me kualifikimin Muratorë dhe Punëtor të Ngjashëm, në pjesën 3, pika 2, ekspertët vlerësojnë se: *"Kualifikimi i prezantuar ka përzierje te objektivave dhe qëllimeve te përgjithshme. Ne kuadër te përbërjes kualifikimi përmban ne kuadër te moduleve kryesore janë edhe module për te cilat ekzistoje profile te veçanta, si: - Kallupimi dhe armirimi i elementeve të ndryshme të skeletit ndërtimor - Përgatitja dhe ekzekutimi i Suvas (Suvatimi i mureve dhe tavaneve), - Vendosja e Estrihut (ibercugut) - Aplikimi i vendosjes së pllakave të qeramikës dhe pllakave të tjera Është e qarte se tentative është te ofrohen aftësim per shumicën e aktiviteteve te ndërtimit, qofte te vrazhdë qofte te ndërtimit final përmes profilit te "Muratorit dhe Punëtorëve te ngjashëm.". Kjo është ne kundërshtim me qëllimin e kualifikimi. Do te mund qe këto module te fuzohen dhe te ofrohen si module mbështetëse pa te drejte për certifikim për to. Kjo është dhënë edhe si rekomandim dhe nuk është plotësuar. Për Modulin 5 - Kallupimi dhe armimii i elementeve të ndryshme të skeletit ndërtimor; institucioni është rekomanduar te e kufizoj ketë modul për ofrimin e aftësimit për elemente vijore vetëm por nuk është përfillë"*, si dhe në pikën 4 të pjesës 3 ekspertët vlerësojnë se: *"Moduli kryesore i këtij profili, Moduli IV – "Muratimi me blloqe dhe tulla si dhe montimi i strukturave prej guri." Tek pjesa b) e dokumentit Programi nuk përmban rezultatet fondamentale mësimore qe duhet te i përmbaje ky modul qe janë te përshkruara ne Standardin e Profesionit, siq janë: - Muratimi me lloje te ndryshme te materialeve ndërtimore - Muratimi i elementeve me forma te ndryshme - Perforcimi i elementeve te muratu - res, etj. Kandidati i cili do te ndjeke ketë modul nuk do te aftësohej fare për këto aktivitete te ndërtimit"*, si dhe në pikën 5 të pjesës 3 ekspertët vlerësojnë se: *"Numër te orëve janë mjaftueshëm te dedikuara por nuk janë te shpërndara neper RM te moduleve, andaj nuk dihet se ne cilin RM sa ore do te zhvillohen dhe si"*, si dhe në pikën 6 të pjesës 3 ekspertët vlerësojnë se: *"Ne kuadër ta Aplikacionit janë paraqitur numri total i kredive për tere kualifikimin, mirëpo nuk janë te përcaktuara numri i kredive neper Modulet përkatëse. Nuk dihet cili modul sa kredi ofron"*.

Ekipi i ekspertëve vlerësues në raportin e validimit për institucionin KTC, lidhur me kualifikimin Muratorë dhe Punëtor të Ngjashëm, në pjesën 4 B, nw pikat 4, 5 dhe 6 *"Kualifikimet e bazuara në standarde kombëtare te profesionit"*, ekspertët vlerësojnë se:

"Rezultatet Mësimore ta paraqitura në ne dokumentin *"Programi" nuk janë ne harmoni me qëllimin e profilit. 1. Janë paraqitur RM te cilat nuk janë pjese thelbësore e profilit "Murator dhe punëtore te ngjashëm" për te cilat ka profile te veçanta, siç janë:, Suvatimi, shtrimi i dyshemesë, shtrimi i pllakave. 2. Ne kuadër te modulit kryesore Modulit IV nuk janë te paraqitura RM te mjaftueshme për arritjen e kualifikimit pre kandidatin"*, pika 5 *"1. Nuk ka ndonjë procedure te definuar për vlerësimin ne ndërmarrje. 2. Vlerësimi ne institucion është shume i mangët sepse: a) Nuk ka test përfundimtar praktik për modulet kryesore b) Testi përfundimtarë për tere programin është shume i mangët dh nuk mundëson vlerësimin e arritshmerise për kandidatet qe përfundojnë trajnimin"*, si dhe pika 6 *"Kualifikimi do te mund te ofroje njohuri bazike por jo te mjaftueshme për te mundësuar angazhimin si punëtorë i kualifikuar për nivelin e III sipas KKK"*.

Në raportin e akreditimit në piken ku trajtohet **"Vlerësimi për plotësimin e kritereve të kualifikimit nga institucioni për ofrim, vlerësim dhe certifikim"**, ekspertët vlerësojnë se: *"Qendra nuk posedon hapësirë të mjaftueshme për vijimin e praktikes profesionale në punëtorinë e prezantuar. Duhet të ketë hapësire që të mundësoj praktikimin e të gjitha elementeve ndërtimore te parapara në RM të moduleve përkatës për kualifikimin "Muratorë dhe punëtor të ngjashëm"*. Në raportin e akreditimit në piken 4 dhe 5 ku trajtohet **"Vlerësimi për plotësimin e kritereve të kualifikimit nga institucioni për ofrim, vlerësim dhe certifikim"**, ekspertët vlerësojnë se: *"Hapësira praktike qe posedon institucioni nuk mundëson vijim te aktiviteteve profesionale te kërkuara për këtë profil"*, respektivisht: *"Institucioni nuk ka marrëveshje me punëdhënës për te mundësuar punësimin, qofte edhe për një kohe si praktikant te kandidateve"*.
Këshilli Drejtues i AKK-së mbështetur në raportin e ekspertëve vlerësues lidhur me validimin dhe akreditimin e institucionit "Instituti për kualifikime profesionale KTC" për kualifikimin: Muratorë dhe Punëtorë të Ngjashëm, niveli (III) sipas KKK, me 25 kredi të AAP, mbështetur në të gjeturat e eksperteve të dhëna në: Raportin vlerësues për validim dhe Raportin vlerësues për akreditim vendosi si në piken tre (III) të dispozitivit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit, Instituti për kualifikime profesionale KTC, dhe

2. Arkivit të AKK-së.

Besim MUSTAFA, PhD, EDBA

Kryetar i KD të AKK